

**AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**

NO AR SHOES

Sot, më datë 10.04.2022, personalisht:

- **Ndoj KOLA**, i biri i Kolë-s, i datëlindjes 04.01.1988, shtetas shqiptar, lindur ne Shkoder dhe banues ne Rr.Pavaresia, L.13,Plazh, Durres. person madhor me zotësi të plotë për të vepruar, me cilësinë e ortakut të shoqërisë tregtare NO AR SHOES Sh.p.k.
- **ASC SERVICE shpk**, shoqeri tregtare, e rregjistruar me NIPT L62218505D, me seli ne adresen Ruga Tefta Tashko Koço, Pallati 20, Hyrja 14, apartamenti 10, Tirane, perfaqesuar nga Administratorja Znj. Gerta HASMUÇA, person madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, me cilësinë e ortakut të shoqërisë tregtare NO AR SHOES Sh.p.k.

Përpilojne këte akt themelimi të shoqërisë tregtare **NO AR SHOES sh.p.k.**, me termat e mëposhtme:

NENI 1

Të themelojnë Shoqërinë Tregtare NO AR SHOES SH.P.K, në formën e një Shoqërie me përgjegjësi të kufizuar. Në të gjitha aktet që do të nxjerrë shoqëria kundrejtuar të tretëve si dhe në të gjitha aktet e brendshme të saj, do të shënohet detyrimisht emri NO AR SHOES SH.P.K, sipas përcaktimeve të bëra në këtë Akt Themelimi dhe në Statut.

NENI 2 Qëllimi i krijimit të Shoqërisë.

Qëllimi i krijimit të kësaj Shoqërie është zhvillimi i aktivitetit ekonomik në fusha të ndryshme. Veprimtaria e kësaj Shoqërie do të jetë thellësisht me karakter ekonomik dhe qëllim fitimprurës.

NENI 3 Emri dhe vula e shoqërisë

Shoqëria, do të dalë në qarkullimin juridiko - civil me emrin e subjektit NO AR SHOES SH.P.K dhe me emrin tregtar NOAR SHOES. Ajo do të ketë edhe vulën e saj.

NENI 4 Objekti i veprimtarisë

Veprimtaria e shoqërisë do të jetë:

Aktivitet fason i veshjeve të këmbës (çizme, kepucë, sandale etj) për llogari të palëve të treta, dhe të gjithave proçeseve që lidhen me to, duke përfshirë import eksport me qëllimin e mësipërm.

NENI 5 Selia e Shoqërisë dhe Afati

Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën: Rruga Pireu, Kapanoni 1, Lagjia 14, Shkozët, Durres.

Faqe 1 nga 3

Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj për një periudhe kohore pa afat.

NENI 6 Kapitali i Shoqërisë

Kapitali themeltar eshte 100.000 (njeqind mijë) Lek dhe zotërohen nga ortaket themelues

Vlera totale e kapitalit te rregjistruar: 100.000 leke

Vlera e paguar: 100.000 leke

Numri total i kuotave: 2.

Kapitali themeltar eshte mbuluar tërësisht nga ortaket themelues.

NENI 7

Ortak themelues te Shoqërisë Tregtare "NO AR SHOES" Sh.p.k zotërojne kuotat në këtë shoqëri si më poshtë:

- **Ndoj KOLA:** pjesemarrja ne perqindje 75 %, 1 kuotë, lloji i kontributit ne para, ne shumen 75.000 leke.
- **ASC SERVICE sh.p.k:** pjesemarrja ne perqindje 25 %, 1 kuotë, lloji i kontributit ne para, ne shumen 25.000 leke.

NENI 8 Organet Drejtuese

Duke ju referuar ligjit nr. 9901, datë 14/04/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", organet drejtuese të shoqërisë janë si më poshtë vijon:

1. Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve – organi më i lartë vendimarrës;
2. Administratori – organi ekzekutiv dhe administrativ i shoqërisë.

NENI 9 Administratoret

Shoqëria administrohet nga ana e Administratoreve të cilët zgjidhen për një mandat 4 (kater) vjeçar me të drejtë rizgjedhje. Administratori i parë i shoqërisë do të jetë nje nga ortaket Z. **Ndoj KOLA.**

Shoqëria përfaqësohet para çdo organi administrativ, gjyqësor, enti publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga administratoret, te cilet i ushtrojne këto të drejta në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjisacionin në fuqi.

NENI 10

Ortaket mund të vendosin me vullnetin e tyre, për pjesmarrjen në Shoqëri të tjera dhe të krijojnë çdo lloj aktiviteti tjetër privat, me përjashtim të kufizimeve të përcaktuara me ligj.

NENI 11

Të punësuarit dhe të ngarkuarit me drejtimin e Shoqërisë mbajnë përgjegjësi dhe detyrohen të zhdëmtojnë Shoqërinë për dëmet që i janë shkaktuar për faj të tyre.

Faqe 2 nga 3

NENI 12

Mosmarrveshjet për themelimin e Shoqërisë zgjidhen me mirekuptim dhe kur kjo nuk arrihet, ato zgjidhen nga Gjykata kompetente.

NENI 13

Akti i themelimit pasi u lexua nga Ortaket Themelues u gjet sipas vullnetit të tyre dhe u nënshkrua pa vërejtje. Akti i Themelimi hartohet në gjuhën shqipe.

ORTAKET THEMELUES**Ndoj KOLA****ASC SERVICE sh.p.k**

Administratore
Gerta HASMUCA

